

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

Taksimi i përgjegjshëm gjinor: Heqja e taksave për produktet esenciale të higjienës menstruale

Përgatitur nga Emnera Dushica për Rrjetin e Grave të Kosovës, si pjesë e Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor¹

Hyrje

Buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është obligim ligjor për të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës që nga viti 2015². Në përputhje me zotimet ligjore të Kosovës,³ dhe [praktikat më të mira](#) ndërkombëtare të BPGj, të gjitha ligjet dhe politikat, duke përfshirë këtu buxhetet, duhet të bazohen në një analizë gjinore. Analiza gjinore merr në konsideratë nevojat dhe prioritetet ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave. Kjo analizë duhet të përdoret për të informuar politikat e bazuara në të dhëna ekzistuese⁴. Sado që BPGJ-ja shpesh përqendrohet më shumë në shpenzime, të ardhurat e Qeverisë duke përfshirë tatimet janë po aq të rëndësishme kur flasim për këtë çështje.

Menaxhimi i higjienës menstruale është një çështje e të drejtave të njeriut dhe produktet e higjienës menstruale janë esenciale për gratë dhe vajzat⁵. Megjithatë, në Kosovë dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, produktet e higjienës menstruale nuk trajtohen si produkte esenciale. Përkundrazi, ato taten si produkte luksi. Kjo përmbledhje e politikave tregon qartë pse Qeveria e Kosovës duhet të heqë taksën prej 18% për produktet menstruale, duke rritur kështu mirëqenien e grave dhe vajzave në përputhje me zotimet e tyre për zbatimin e BPGJ-së, avancimin e të drejtave të njeriut si dhe arritjen e barazisë.

Analizë e Situatës në Kosovë

Sipas Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Udhëzimeve Administrative të tij, në Kosovë zbatohen dy norma të ndryshme të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për mallëra dhe shërbime.⁶ Së pari, norma standarde e TVSH-së prej 18% vlen për të gjitha produktet të cilat nuk konsiderohen si esenciale, dhe trajtohen si produkte luksi. Së dyti, shkalla e reduktuar e TVSH-së prej 8% zbatohet, ndër të tjera për; mallrat esenciale si kontraktivët dhe produktet farmaceutike. Pecetat higjienike dhe tamponët nuk janë të përfshira në listën e mallrave esenciale me TVSH të reduktuar, kjo pavarësisht se janë produkte të domosdoshme dhe shumë të kërkuara nga të gjitha vajzat dhe gratë në Kosovë.

¹ Shkrimi i këtij përmbledhje është mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) përmes Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor. Pikëpamjet janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA ose Sida.

² [Ligji Nr. 05/L-020](#) për Barazi Gjinore, neni 1.17.

³ Ibid.

⁴ Kjo është gjithashtu një kërkesë e [Vlerësimeve të Ndikimit Gjinor](#) si pjesë e Vlerësimeve të Ndikimit Rregullator, të përfshira në [Strategjinë e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021](#).

⁵ Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, [Dita e Higjienës Menstruale: Raportues Special për të drejtat e njeriut për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta](#).

⁶ [Ligji Nr. 05/L-037](#) për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; [Udhëzimi Administrativ 03/2015](#) për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Në vend të kësaj të fundit, në këto produkte zbatohet TVSH-ja standarde prej 18%, e cila është e njëjtë me të gjitha produktet e tjera të luksit. Siç tregohet nga hulumtimi i fundit i bërë nga organizata anëtare e RrGK-së, EcoKos Women (EKW), kostoja shtesë nga kjo taksë kontribuon në thellimin e pabarazive ekonomike mes grave dhe burrave si dhe kufizon qasjen në produkte higjienike menstruale për një numër të konsiderueshëm të grave.

EKW ka vlerësuar se një grua/vajzë shpenzon afërsisht 4.6€ në muaj dhe 56€ në vit për produkte menstruale. Duke marrë parasysh se shkalla e punësimit të grave në Kosovë është vetëm 14.1%⁷ shumica dërrmuese e grave/vajzave nuk mund t'i blejnë këto produkte me të ardhurat e tyre dhe kështu ato varen nga të tjerët. Kjo i vendos gratë dhe vajzat, veçanërisht ato që jetojnë në varfëri, në një situatë varësie dhe kushte potencialisht të pasigurta. EKW ka konstatuar se kostoja e produkteve të menstruacioneve madje ka penguar disa gra që të kenë qasje në arsim, punë dhe proceset e vendimmarrjes.

Për më tepër, të dhënat zyrtare nga Dogana e Kosovës sugjerojnë se të hyrat nga TVSH-ja (0.0532%) dhe taksat doganore (0.0115%) për produktet e higjienës menstruale përbëjnë 0.065% të totalit të të hyrave doganore në vitin 2019 dhe akoma më pak nga të hyrat e përgjithshme shtetërore. Kështu, heqja e taksave doganore dhe TVSH-së për produktet menstruale vështirë se do të ndikonte në të ardhurat totale të Kosovës, por do të ndihmonte ndjeshëm gratë dhe vajzat, veçanërisht ato që jetojnë në familje të varfra.

Opsionet e mundshme

Çdo e ardhur "e humbur" nga heqja e taksave për produktet menstruale mund të mblidhet me mjete të tjera. Për shembull, rritja e taksave për makinat luksoze do të rriste ndjeshëm të ardhurat e qeverisë. Kjo do të taksonte një produkt që është thjesht produkt luksi, dhe do të mblidhte të ardhura nga personat që mund të përballojnë produkte të tilla. Kjo zgjidhje alternative mund të ndikojë gjithashtu pozitivisht në mjedis, veçanërisht nëse qeveria do të rriste më tej taksat për këto produkte dhe do t'i përdorte ato për nisma për të luftuar ndotjen, për të mirëmbajtur rrugët ose për programe të tjera sociale.⁸ Një alternativë tjetër mund të jetë rritja e akcizës për alkoolin apo substanca tjera, të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin e qytetarëve dhe nuk janë thelbësore, siç janë produktet menstruale. Nëse në Kosovë do të vendosej një akcizë më e lartë për alkoolin, të hyrat do t'i kalonin shumë të hyrat e sjella nga taksat për produktet menstruale.

Rekomandime

Sipas obligimeve të qeverisë për zbatimin e BPGJ-së, ne rekomandojmë që të ndryshohet Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si dhe Udhëzimi Administrativ Mof- Nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, kështu që produktet e higjienës menstruale të lirohen nga të gjitha taksat e doganës dhe TVSH-ja. Analiza gjinore sugjeron se kjo do të shkojë në të mirën e familjeve me të ardhura të ulëta dhe do të kontribuojë në avancimin e barazisë në mbledhjen e të ardhurave shtetërore duke hequr këtë taksë diskriminuese për gratë.

⁷ ASK, [Anketa e Fuqisë Punëtore 2020](#).

⁸ Kanadaja është një nga shembujt më të mirë të kësaj praktike (Qeveria e Kanadasë, [Konsultimet mbi Taksën e Përzgjedhur të Mallrave Luksoze](#)).